



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 257 Prot.

Tiranë, më datë 22. 05.2026

VENDIM
Nr. 181, datë 22.05.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.05.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e Konceptit për kryerjen e gërmimeve dhe sondazheve arkeologjike hartuar në kuadër të projektit “Menaxhimi i sitit, planet interpretative, përvoja e vizitorëve, dizanjimi dhe mbikqyrja për sitet turistike “Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën Spile” ndërhyrjet strukturore për rritjen e stabilitetit të shkëmbit në “Kalanë e Borshit” me aplikues Cultural Heritage Without Borders dhe zhvillues **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**;
2. Rezultati i sondazheve arkeologjike duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

